



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësua
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.922/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësua (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Adnan Konushevc, kryesues, Kymete Kicaj dhe Ferki Xhaferi anëtar, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Podujevës, Qëndrim Xheladini nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Komunën e Podujevës, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 të datës 03.11.2021 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021 për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 07.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

Hudhet i palejuar apelin Anr.922/2021, i datës 04.11.2021, paraqitur nga Qëndrim Xheladini nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës(LDK), dega në Komunën e Podujevës, kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar apelin me datën 04.11.2021 nga anëtari për Kuvend Komunal në Komunën e Podujevës, Qëndrim Xheladini nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Komunën e Podujevës, me të cilin pretendon se në vendvotimin 1808E/02D në fshatin Bajqinë të Podujevës në listat e publikuara nga KQZ nuk i figurojnë tri vota të familjes Sevdaim Salihu dhe mendon se ka pasur parregullsi në këtë VV sepse nuk i ka dalur asnjë votë. Në vendvotimin 1807E/01R në fshatin Bradash të Podujevës i figuron vetëm një votë, ndërsa votuesi Xhevat Azemi thekson se ka deklaruar se e ka votuar me tre anëtar të familjes së tij. Në vendvotimin 1812E/02R në fshatin Gllamnik të Podujevës ka vetëm një votë, ndërsa thekson se votuesi Vedat Musa ka garantuar se e ka votuar me katër anëtarë të familjes dhe këto vota nuk i figurojnë në formularët e KQZ-së.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i palejuar

Paneli pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se apeli i paraqitur nga ankuesi në këtë rast ka të njëjtat kërkesa dhe të njëjtin objekt, gjendje të njëjtë faktike siç është vendosur vendosur me vendimin e PZAP-it Anr.848/2021 të datës 05.11.2021.

Meqenëse për rastin në fjalë është vendosur me vendimin e PZAP-it, Anr.848/2021 të datës 05.11.2021, dhe pasi që për të njëjtin çështje është vendosur në vendimin e lartcekur paneli nuk u lëshua fare në shqyrtim të kësaj çështje të theksuar në ankesë.

Paneli, duke u bazuar në arsyet e cekuar më lartë e po ashtu në pajtim me dispozitat e nenit 6.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it 02/2015, si dhe në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.922/2021 më datë 07.11.2021**



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.